

PROCESVERBAL
nga seanca e nëntë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 25.8.2025

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Petar Xhurovski.

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Punonjësit nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunović mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e nëntë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 11:05 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e tetë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 21.8.2025.
2. Propozim-vendim për anulimin e vendimit për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendësit të drejtorit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
3. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën në vijim për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtje dhe servisimi i ashensorëve dhe platformës.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë, për arsye teknike, njëzëri ka anuluar miratimin e Procesverbalit nga seanca e tetë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 21.8.2025.

Pika 2

Z. Stefanovski, në lidhje me propozim-vendimin për anulimin e miratimit të vendimit për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendësit të drejtorit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, informoi se, në pajtim me propozimin e Sektorit për çështje juridike, ka pranuar që kjo pikë të përfshihet në rendin e ditës të seancës së sotme.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi vendimin me të cilin ka anuluar miratimin e vendit për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen (emërimin) e drejtorit dhe zëvendësit të drejtorit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele deri në përfundimin e zgjedhjeve për anëtarë të këshillave të komunave dhe Këshillit në Qytetin e Shkupit dhe për kryetarët e bashkive në komunat dhe për kryetar bashkie në Qytetin e Shkupit, përkatësisht deri në konstituimin e Këshillit të komunave dhe Qytetit të Shkupit.

Vendimi për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendësit të drejtorit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele të miratohet në aft prej 15 ditësh nga dita e përfundimit të zgjedhjeve për anëtarë të këshillave të komunave dhe Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe për kryetarët e bashkive dhe kryetar bashkie të Qytetit të Shkupit, përkatësisht deri në konstituimin e Këshillit të komunave dhe Qytetit të Shkupit.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi propozimin për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën në vijim për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtje dhe servisim i ashensorëve dhe platformës. Ai shpjegoi se bëhet fjalë për furnizim publik standard, por jashtëzakonisht i rëndësishëm nga aspekti i sigurisë së punonjësve. Furnizimi do të zbatohet së bashku me Ministrinë e Sportit, nga ku shpenzimet do të ndahen në raport 35% që mbulohen nga Ministria dhe 65% nga Agjencia.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, znj. Cvetanka Mitrevska, informon që ky furnizim publik është parashikuar në Planin Vjetor për furnizim publik të Agjencisë për vitin 2025, ndërsa mjetet sigurohen në pajtim me Planin financiar. Kontrata që do të rezultoi nga procedura e kryer do të lidhet për periudhë prej 2 (dy) vitesh. Procedura do të zbatohet si procedure e hapur e thjeshtë dhe do të fillon me publikim në shpalljes nëpërmjet Sistemit Elektronik për furnizim publik dhe në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut". Znj. Mitrevska ka shtuar se të gjitha informacionet shtesë në lidhje me furnizimin përmbahen në materialet e paraqitura sipas kësaj pike të rendit të ditës.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtja dhe servisimi i ashensorëve dhe platformës.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Mirëmbajtja dhe servisimi i ashensorëve dhe platformës për periudhë prej 2 (dy) vitesh është parashikuar dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr. 05-3061/1 datë 21.7.2025, dhe mjetet janë siguruar nga Plani

Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025, përkatësisht ato do të sigurohen shtesë nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

Pika 4

Të ndryshme

Nuk pati diskutim nën pikën "Të ndryshme".

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,**

Mr. Sasho Stefanovski